Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në _____ rast _____ BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

AKTIVITETI 1

1	2	3				
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Shërbim animator (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1			
2	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me përmasa 28x37 cm të printuar	m/linear	200			
3	Copë beze e printuar me imazh për ngjyrosje me bojra akrelik me diametër 2m	m/linear	50			

4	Grup kërcimi me fëmijë dhe të rinj (1 orë)	shërbim	1			
5	Workshop poçerie për 20 persona	shërbim	1			
6	Moderator (4 orë)	shërbim	1			
7	Këngëtar të zhanrit popullor	shërbim	2			
8	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit (4 orë)	shërbim	1			
9	Grup Sportiv Taekwondo	shërbim	1			
10	Grup Sportiv Judo	shërbim	1			
11	Instruktor Yoga	shërbim	1			
12	Ekspozitë atelie me kostume dhe punime popullore	shërbim	1			
13	Grup muzikor me muzikë alternative	shërbim	1			
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

AKTIVITETI 2

1	2	3				
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Ekspozitor metalik i personalizuar me imazhe të ndryshme me përmasa 1m x 1.5m	copë	10			
2	Pikturë më bojra neoni në kanavacë dhe trup për 10 persona	shërbim	1			
3	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit (3 orë)	shërbim	1			
4	Instruktor Yoga	shërbim	2			
5	Instruktor Pilates	shërbim	1			
6	Sporte ujore KAYAK	shërbim	2			
7	Workshop poçerie (20 persona)	shërbim	2			
8	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1			
9	Workshop me kostume dhe punime artizanale tradicionale 20 persona	shërbim	1			
10	Tenda Dielli	copë	10			
11	Show me rërë (sand art)	shërbim	1			
12	Grup Jazz 2 orë	shërbim	1			
13	Këngëtar lirik 2 orë	shërbim	2			

14	Regjisor	shërbim	1			
15	Moderator 3 orë	shërbim	1			
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

AKTIVITET 3

1	2	3				
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)200x100 cm	copë	1			
2	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)174x80 cm	copë	1			
3	Strukturë gjysëm harku me tullumbaca kuq e zi me përmasa 4.5 m x 3 m	copë	1			
4	Tollumbace me helium	copë	300			
5	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1			
6	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me permasa 28x37 cm te printuar	m/linear	200			
7	Workshop me piktor 3 orë	shërbim	1			
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

AKTIVITET 4

1	2	3				
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Grup kërcimi	shërbim	2			
2	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1			
3	Kengëtar	shërbim	2			
4	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 4 orë	shërbim	1			
5	Band muzikor rinor	shërbim	1			
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						

Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

TABELA PERMBLEDHESE PER TE GJITHA AKTIVITETET

1	2	3				
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Band muzikor rinor	shërbim	1			
2	Copë beze me diameter 2m e printuar	m/linear	50			
3	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 3 orë	shërbim	1			
4	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 4 orë	shërbim	2			
5	Ekspozitë atelie me kostume dhe punime popullore	shërbim	1			
6	Ekspozitor metalik i personalizuar me imazhe të ndryshme me përmasa 1mx1.5m	copë	10			
7	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me permasa 28x37 cm te printuar	m/linear	400			
8	Grup Jazz 2 orë	shërbim	1			

9	Grup kërcimi me fëmijë dhe të rinj (1 orë)	shërbim	1			
10	Grup muzikor me muzikë alternative	shërbim	1			
11	Grup Sportiv Judo	shërbim	1			
12	Grup Sportiv Taekwondo	shërbim	1			
13	Grup kërcimi	shërbim	2			
14	Instruktor Yoga	shërbim	3			
15	Këngëtar	shërbim	2			
16	Këngëtar të zhanrit popullor	shërbim	2			
17	Këngëtar lirik 2 orë	shërbim	2			
18	Moderator 4 orë	shërbim	1			
19	Moderator 3 orë	shërbim	1			
20	Pikturë më bojra neoni në kanavacë dhe trup për 10 persona	shërbim	1			
21	Regjisor	shërbim	1			
22	Instruktor Pilates	shërbim	1			
23	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	4			

24	Show me rërë (sand art)	shërbim	1			
25	Sporte ujore KAYAK për 10 persona	shërbim	2			
26	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)174x80 cm	copë	1			
27	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)200x100 cm	copë	1			
28	Strukturë gjysëm harku me tullumbaca kuq e zi me përmasa 4.5 m x 3 m	copë	1			
29	Tenda Dielli	copë	10			
30	Tollombace me helium	copë	300			
31	Workshop (trajnim)me kostume dhe punime artizanale tradicionale 20 persona	shërbim	1			
32	Workshop (trajnim)me piktor 3 orë	shërbim	1			
33	Workshop (trajnim)pocerie 3 orë 20 persona	shërbim	3			
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Date _____		

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

AKTIVITETI 1

Specifikimet teknike

- 1. Shërbim animatorë** (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme). Numri i animatorëve jo më pak se 4 persona, të ofrojnë loja interaktive, kërcim, këngë. Koha e shërbimit 3 orë.

Face Painting: Materiali duhet të jetë profesional, hipoalergjik dhe i sigurt për lëkurën. Të hiqet lehtësisht me ujë dhe me sapun. Koha e shërbimit 3 orë në varësi të aktivitetit.

Kllounët të jenë me kostume me ngjyra të gjalla dhe dizajn tërheqës dhe të ndërvrejnë me fëmijët. Koha e shërbimit 3 orë.

Xhonglierët duhet të bëjnë manipulime të ndryshme me topa, shkopinj dhe unaza. Koha e shërbimit 3 orë.

Maskotat duhet të jenë personazhe të animuara, superheronj etj. Duhet të ndërveprojnë me fëmijët, të bëjnë fotografi me ta dhe të marrin pjesë në lojra të ndryshme. Koha e shërbimit 3 orë.

2. Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv

Dekor festiv i përbërë nga flamuj trekëndorë tekstili prej pambuku me dimensione **28 cm x 37 cm**. Flamujt do të jenë të lidhur me një shirit 8 metra të gjatë, të përshtatshëm për vendosje në ambiente të hapura.

Operatori ekonomik duhet të kryejë edhe vendosjen e flamurëve.

3. Copë beze e printuar me imazh për ngjyrosje me bojra akrelik, me diametër 2 m

Element kreativ dhe interaktiv i përbërë nga një rreth bezeje të bardhë me **diametër 2 metra**. Sipërfaqja e bezeve do të jetë e printuar me ilustrime të përshtatshme për fëmijët, të cilat do të ngjyrosen me bojra akrelik gjatë aktivitetit.

Dizajni do të jetë i frymëzuar nga modeli referues në imazh, duke krijuar një hapësirë argëtuese dhe edukative për fëmijët që të shprehin krijimtarinë e tyre përmes ngjyrave.



4. **Grupe kërcimi me fëmijë dhe të rinj** të përbërë nga 10-15 fëmijë me moshë 7-16 vjeç të cilët do të performojnë kërcime të ndryshme në varësi të tematikës së aktivitetit. Kohëzgjatja 1 orë.

5. **Workshop poçerie** Ky workshop është **një eksperiencë relaksuese dhe kreative**, perfekte për fëmijët që duan të mësojnë teknikën e baltës, për 20 persona.

Detajet Kryesore të Workshop-it

Tema: Punime artizanale me baltë dhe qeramikë

Kohëzgjatja: 3 orë

Materialet dhe Pajisjet e Nevojshme

Balta/qeramika: Lloje të ndryshme balte (terracotta, balta e bardhë, etj)

Mjete modelimi: Sfungjerë, thika balte, rrotulla druri, mjete të veçanta për detaje

Rrota poçerie

Pjesëmarrësit punojnë me baltën për të krijuar objekte si:

- Filxhanë
- Pjata
- Vazo të vogla
- Dekorime të vogla qeramike

-
- Ndhimë dhe këshilla nga instruktori gjatë procesit

6. Moderator për të drejtuar një koncert live, duke prezantuar artistët dhe mbajtur të angazhuar publikun gjatë eventit.

Aftësitë dhe Kompetencat

Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe oratorike

Dikcion i pastër dhe zë i fuqishëm, i përshtatshëm për skenë të madhe.

Aftësi për të ndërvepruar me publikun dhe për ta mbajtur të angazhuar.

Energjik, karizmatik dhe me prezencë skenike të fortë.

Aftësi për të prezantuar artistët në mënyrë tërheqëse dhe kreative.

Aftësi për të menaxhuar situata të paparashikuara, si vonesa të artistëve apo probleme teknike.

DETYRAT KRYESORE TË MODERATORIT TË KONCERTIT

Hapja dhe mbyllja e koncertit në mënyrë energjike dhe tërheqëse. **Prezantimi i artistëve dhe performancave** sipas renditjes së programit. **Ndërveprim me publikun** për të ruajtur atmosferën festive. **Njoftimi i sponsorëve, partnerëve dhe mesazheve të rëndësishme.** **Mbushja e kohës me batuta dhe argëtim** në rast të vonesave teknike apo ndërrimit të skenës. **Promovimi i aktiviteteve të tjera të eventit** nëse është e nevojshme.

Kohëzgjatja: 4 orë

7. Këngëtar popullor për performancë live.

KËRKESAT PËR KËNGËTARIN

Repertori i gjerë me këngë popullore nga treva të ndryshme të Shqipërisë.

Zë i fuqishëm dhe i pastër, i përshtatshëm për muzikë live.

Prezencë skenike dhe aftësi për të krijuar atmosferë festive.

Ndërveprim me publikun për të mbajtur energjinë e lartë gjatë performancës.

Aftësi për të përshtatur performancën sipas natyrës së eventit.

Këngë popullore tradicionale.

Këngë qytetare të muzikës së lehtë popullore.

Valle popullore me ndërveprim me publikun.

Lloji i muzikës: Popullore tradicionale (Toskë, Gegë, qytetare, folklorike).

Kohëzgjatja: 2 orë, sipas kërkesës.

8. DJ profesionist për të performuar në evente publike

Repertori i gjerë me **muzikë të personalizuar sipas eventit.**

Eksperiencë në **ndërveprim me publikun dhe krijimin e atmosferës.**

Aftësi teknike në përdorimin e pajisjeve DJ.

Fleksibilitet për të përshtatur performancën sipas llojit të eventit dhe dëshirave të organizatorëve.

Energjik, karizmatik dhe me aftësi për të mbajtur publikun aktiv gjatë gjithë performancës.

Kohëzgjatja: 4 orë

9. Grup sportiv Taekwondo në një aktivitet sportiv me qëllim promovimin e sportit, demonstrimin e teknikave dhe edukimin fizik të audiencës.

- 1-2 instruktorë të licencuar ose me eksperiencë për të drejtuar demonstrimin dhe menaxhuar grupin.
- **60 minuta** në varësi të programit të eventit.
- **Ndërprerje të vogla mes demonstrimeve** për të shpjeguar teknikat dhe për të përfshirë audiencën.

10. Grup sportiv Judo në një aktivitet sportiv me qëllim promovimin e këtij sporti, demonstrimin e teknikave dhe edukimin fizik të fëmijëve.

- 1-2 instruktorë të licencuar ose me eksperiencë për të drejtuar demonstrimin dhe menaxhuar grupin.
- **Kohëzgjatja 60 minuta.**
- **Ndërprerje të vogla mes demonstrimeve** për të shpjeguar teknikat dhe për të përfshirë audiencën.

11. Instruktor të Yoga-s për të ofruar seanca trajnimi dhe udhëheqje të praktikave të Yoga-s për pjesëmarrësit në një aktivitet. Ky program Yoga do të ndihmojë pjesëmarrësit të **përmirësojnë mirëqenien e tyre fizike dhe mendore**, duke ofruar një përvojë të qetë dhe motivuese. **Kohëzgjatja 60 minuta**

12. Ekspozitë atelie me kostume dhe punime popullore që përfshin **kostume tradicionale** dhe **punime popullore**, me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artizanale.

Ekspozita atelie me kostume dhe punime popullore synon të ruajë dhe promovojë pasurinë kulturore të popullit shqiptar, duke ofruar një mundësi të shkëlqyer për audiencën për të mësuar dhe ndërvepruar me artin dhe mjeshtërinë tradicionale.

Përmbajtja e Ekspozitës:

- **Kostume tradicionale popullore** të ndryshme (nga zona të ndryshme të vendit), përfshirë veshje për gra, burra dhe fëmijë.
- **Punime artizanale** si qilima, punime me dorë, etj.
- **Demonstrime të artizanëve** që punojnë me dorë.
- **Punëtori për fëmijët** që mund të provojnë të krijojnë disa punime të thjeshta tradicionale.
- **Prezantim i procesit të krijimit të kostumeve** dhe përdorimit të materialeve tradicionale.

Kohëzgjatja: 4 orë.

13. Grup muzikor me muzikë alternative. Angazhimin e një grupi muzikor me muzikë alternative për performancë live. Grupi duhet të ketë përvojë skenike dhe repertor të përshtatshëm.

Grupi duhet të jetë i përbërë nga jo më pak se pesë persona ku të përfshihen vocalistë instrumentistë të pajisur me instrumenta.

Repertori i zhanrit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kohëzgjatja 120 minuta performancë live.

AKTIVITETI 2

1. **Ekspozitor** metalik i personalizuar me imazhe të ndryshme me përmasa 1m x 1.5m.
2. **Pikturë me bojra neoni në kanavacë dhe trup.** Ofrimi i një performance artistike të tipit pikturë me bojra neoni në kanavacë dhe trup, me tematikë “10 Vjet APR” ku do pikturohet në kanavacë dhe në trup me bojëra fluorescente, duke krijuar efekte vizuale të veçanta në një mjedis të errët. Shërbimi përfshin përgatitjen, realizimin dhe shfaqjen për publikun sipas programit të përcaktuar të aktivitetit.

Artistët realizues: 2 artistë profesionistë të specializuar me përvojë në bojëra neon.
Shërbim me pikturim për 10 persona.

- Materialet:
 - Bojëra UV (fluorescent) të sigurta për përdorim (jo toksike, hipoalergjike, të miratuara dermatologjikisht).
 - Penela, lapsa, brusha dhe mjete të tjera për aplikim preciz.
 - Kanavacë, telajo, këmbaleca
- Kohëzgjatja: Kohëzgjatja e performancës publike: 3 orë në varësi të formatit të eventit
- 3. **DJ profesionist** për të performuar në evente publike me infrastrukturë të nevojshme për ofrimin e shërbimit

Repertori i gjerë me **muzikë të personalizuar sipas eventit**

Eksperiencë në **ndërveprim me publikun dhe krijimin e atmosferës**

Aftësi teknike në përdorimin e pajisjeve DJ

Fleksibilitet për të përshtatur performancën sipas llojit të eventit dhe dëshirave të organizatorëve

Energjik, karizmatik dhe me aftësi për të mbajtur publikun aktiv gjatë gjithë performancës

Kohëzgjatja: 3 orë

4. **Instruktor Yoga.** Seanca trajnimi dhe udhëheqje të praktikave të Yoga-s për pjesëmarrësit në aktivitet. Ky program Yoga do të ndihmojë pjesëmarrësit të **përmirësojnë mirëqenien e tyre fizike dhe mendore**, duke ofruar një përvojë të qetë dhe motivuese. Trajnuesi i yoga duhet të sigurojë të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme që duhen për zhvillimin e seancës së Yoga.
- Siguria dhe përshtatshmëria:
 - Instruktori/e përshtat ushtrimet sipas moshës dhe aftësive të pjesëmarrësve.
 - Përdorim teknikash të sigurta dhe kontroll të formës fizike gjatë seancës.
 - Këshilla për hidratim dhe kujdes individual.

Kohëzgjatja e aktivitetit: 60 minuta

5. **Instruktor Pilates** Ofrimi i një seance fizike të drejtuar nga një instruktor/e i/e certifikuar në Pilates, e fokusuar në përmirësimin e qëndrimit, fleksibilitetit dhe frymëmarrjes së ndërgjegjshme. Seanca zhvillohet në grup dhe përfshin vetëm mjete bazike si dyshek, rrathë ose shirit elastik. Trajnuesi i Pilates duhet të sigurojë të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme që duhen për zhvillimin e seancës së Pilates.

- Siguria dhe përshtatshmëria:

- Instruktori/e përshtat ushtrimet sipas moshës dhe aftësive të pjesëmarrësve.
- Përdorim teknikash të sigurta dhe kontroll të formës fizike gjatë seancës.
- Këshilla për hidratim dhe kujdes individual.

Kohëzgjatja e aktivitetit: 60 minuta

6. Sporte ujore KAYAK

6-8 kajakë.

6 -8 jelekë shpëtimi.

2 instruktorë me certifikim ose me eksperiencë disa vjeçare në këto sporte ujore.

Kohëzgjatja: 3 orë

7. **Workshop (trajnim) poçerie** Ky workshop është **një eksperiencë relaksuese dhe kreative**, perfekte për fëmijët që duan të mësojnë teknikën e baltës, për 20 persona.

Detajet Kryesore të Workshop-it

Tema: Punime artizanale me baltë dhe qeramikë

Kohëzgjatja: 3 orë

Materialet dhe Pajisjet e Nevojshme

Balta/qeramika: Lloje të ndryshme balte (terracotta, balta e bardhë, etj)

Mjete modelimi: Sfungjerë, thika balte, rrotulla druri, mjete të veçanta për detaje

Rrota poçerie

Pjesëmarrësit punojnë me baltën për të krijuar objekte si:

- Filxhanë
- Pjata
- Vazo të vogla
- Dekorime të vogla qeramike

• Ndihmë dhe këshilla nga instruktori gjatë procesit

8. **Shërbim animatorë** (piktura ne fytyre, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme).

Numri i animatorëve jo më pak se 4 persona, të ofrojnë lojra interaktive, kërcim, këngë.

Koha e shërbimit 3 orë.

Face Painting: Materiali duhet të jetë profesional, hipoalergjik dhe i sigurt për lëkurën. Të hiqet lehtësisht me ujë dhe me sapun.

Koha e shërbimit 3 orë në varësi të aktivitetit.

Kllounët të jenë me costume me ngjyra të gjalla dhe dizajn tërheqës dhe të ndërvrejnë me fëmijët.

Koha e shërbimit 3 orë.

Xhonglierët duhet të bëjnë manipulime të ndryshme me topa, shkopinj dhe unaza. Koha e shërbimit 3 orë.

Maskotat duhet të jenë personazhe të animuara, superheronj etj. Duhet të ndërveprojnë me fëmijët, të bëjnë fotografi me ta dhe të marrin pjesë në lojra të ndryshme.

Koha e shërbimit 3 orë.

9. Workshop (trajnim) me kostume dhe punime artizanale tradicionale

Përshkrim i Shërbimit:

Workshop-i ka për qëllim të mësojë dhe promovojë zanatet tradicionale shqiptare përmes përfshirjes aktive të **20** pjesëmarrësve në punime manuale si qëndisje, thurje, punime me grep dhe teknika të tjera tradicionale.

Detajet Teknike të Shërbimit:

- Kohëzgjatja e workshop-it: 3 orë

Stafi i angazhuar:

- 1 (një) instruktor/artizan profesionist me përvojë në zanatet tradicionale shqiptare.
- Personi duhet të ketë aftësi për demonstrim praktik dhe komunikim të qartë të teknikave.

Materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e workshop-it:

- Fije pambuku ose leshi në ngjyra tradicionale
- Gropa metalikë për punime me grep
- Gërshërë të vogla për përdorim manual
- Mostra punimesh si referencë vizuale
- Kartonë, kallëpe ose letër ndihmëse për vizatim/paraskicim
- Tavolina pune ose baza mbështetëse (nëse në natyrë, mbulesa ose tapetë)
- Karrige ose ulëse të lehta për pjesëmarrësit
- Broshura ose fletë informuese për teknikën dhe historikun e zanatit

Kërkesa të veçanta për materialet:

- Të jenë të siguruara paraprakisht nga operatori ekonomik
- Të jenë të sigurta për përdorim (jo të mprehta për fëmijë në rast pjesëmarrjeje të tyre)
- Të jenë në përputhje me standardet artizanale dhe estetike të zanatit përkatës

Kushtet e ofrimit të shërbimit:

- Shërbimi duhet të ofrohet në një ditë të vetme, në orarin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor
- Operatorët ekonomikë duhet të garantojnë instalim, ofrim dhe pastrim të zonës pas përfundimit të aktivitetit

10. Tenda dielli

Emërtimi i produktit:

Tenta Dielli Dekorative

Përdorimi i synuar:

Për vendosje në ambient të hapur gjatë aktiviteteve kulturore, panairove, eventeve ekspozuese ose zonave lounge, me vlerë estetike dhe funksionale për mbrojtje nga dielli.

1. Struktura dhe materiali

- Diametri i tendës: 2.5 – 3.0 metra
- Lartësia totale: minimumi 2.2 m
- Materiali i mbulesës: Kanavacë pambuku ose material tekstili të trashë me veshje rezistente ndaj kushteve atmosferike
- Ngjyra & dizajni: Ngjyra pastel ose e butë me motive vintage (bezhë, vishnje, e verdhë e zbehtë, etj.)
- Skajet: me dekorim rrethor në fund (frruda ose valë të qepura) sipas stilit retro

2. Struktura mbajtëse

- Sistemi i hapjes: duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i lehtë për përdorim në ambjent të jashtëm.

3. Rezistenca dhe specifika të tjera

- Rezistente ndaj ekspozimit të vazhdueshëm në diell dhe ndryshimeve të motit- Stabilitet në erë
- Të përfshihen pjesët e fiksimit dhe transportit

4. Kërkesa të tjera teknike

- Montimi dhe çmontimi i thjeshtë dhe i shpejtë

11. Shfaqje me rërë (sand art)

Shërbimi konsiston në realizimin e një performance artistike në artin e rërës, ku një artist vizaton në kohë reale me rërë mbi një sipërfaqe ndriçimi të veçantë, duke krijuar imazhe vizuale dhe tregime figurative që përcillen në një ekran për audiencën.

Detajet Teknike të Shërbimit:

- Kohëzgjatja e shfaqjes: 60 minuta
- Formati: Shfaqje vizuale live me krijim figurativ me rërë, me kalime artistike tematike
- Tema: e personalizueshme sipas kërkesës së organizatorit (p.sh. “10 vite APR”, “Natyra dhe Qyteti”, etj.)

Stafi i kërkuar:

- 1 (një) artist profesionist i specializuar në artin e rërës (të kërkohej portofol ose dokument referues)
- Eksperiencë në evente kulturore dhe performanca live.

Pajisje dhe logjistikë që ofrohen nga operatori ekonomik:

- Pajisja profesionale e Sand Art (tavolinë me ndriçim LED të integruar)
- Rërë e imët e përzgjedhur, e përshtatshme për vizatim të imët.
- Kamera që transmeton në kohë reale vizatimet në ekran.
- Strukturë e stabilizuar për mbrojtje nga era.
- Të gjitha pajisjet elektrike duhet të jenë të sigurta dhe në përputhje me standardet teknike

Kushtet e ofrimit të shërbimit:

- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve duhet të kryhet të paktën 1 orë para eventit

- Operatorët ekonomikë të sigurojnë gjithçka për funksionimin teknik dhe artistik të shfaqjes
- Artistët duhet të kenë përvojë të mëparshme në realizimin e sand art për publik
- Organizatori mban të drejtën të kërkojë paraprakisht draftin e sekuencave të temës së shfaqjes

12. Grup Jazz i përbërë nga tre persona

Ofrimi i një performance të muzikës Jazz live nga një grup profesionist muzikor, i përbërë nga instrumentistë dhe/ose vokalistë, që interpretojnë repertor klasik, modern ose improvizime në stilin Jazz. Performanca synon të krijojë një atmosferë të rafinuar, artistike dhe relaksuese për audiencën.

Grup duhet të jetë i pajisur me instrumentat muzikorë.

Kohëzgjatja: 2 orë

13. Këngëtar lirik. Angazhimi i një këngëtarit lirik solist për një performancë muzikore live, me repertor të zhanrit klasik të huaj dhe shqiptar.

Këngëtar me karrierë artistike solistike koncertore me minimum 5 vite eksperiencë skenike . Kohëzgjatja: 2 orë

14. Regjizor Angazhimi i një regjizori profesionist për konceptim dhe realizim artistik të një mbrëmjeje gala me repertor klasik shqiptar dhe të huaj.

Përgjegjësitë:

Hartimin e konceptit artistik të mbrëmjes gala, duke përcaktuar rrjedhën e programit, hyrjet e solistëve, strukturën skenike dhe ndërthurjen e elementeve muzikore me ato vizuale.

Koordinimin e solistëve, dirigjent, kor orkestër për rrjedhjen e pandërprerë të eventit.

Kohëzgjatja: 8 orë

15. Moderator për të drejtuar një koncert live, duke prezantuar artistët dhe mbajtur të angazhuar publikun gjatë eventit.

Aftësitë dhe Kompetencat

Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe oratorike

Dikcion i pastër dhe zë i fuqishëm, i përshtatshëm për skenë të madhe

Aftësi për të ndërvepruar me publikun dhe për ta mbajtur të angazhuar

Energjik, karizmatik dhe me prezencë skenike të fortë

Aftësi për të prezantuar artistët në mënyrë tërheqëse dhe kreative

Aftësi për të menaxhuar situata të paparashikuara, si vonesa të artistëve apo probleme teknike

DETYRAT KRYESORE TË MODERATORIT TË KONCERTIT


Hapja dhe mbyllja e koncertit në mënyrë energjike dhe tërheqëse. **Prezantimi i artistëve dhe performancave** sipas renditjes së programit. **Ndërveprim me publikun** për të ruajtur atmosferën festive. **Njoftimi i sponsorëve, partnerëve dhe mesazheve të rëndësishme.** **Mbushja e kohës me batuta dhe argëtim** në rast të vonesave teknike apo ndërrimit të skenës. **Promovimi i aktiviteteve të tjera të eventit** nëse është e nevojshme.

Kohëzgjatja: 3 orë

AKTIVITET 3

1-2. Spinwheels (Rrota rrotulluese me Ere) – Element Dekorativ

Element dekorativ i përbërë nga një pjesë rrotulluese plastike dhe një bazament metalik me strukturë mbajtëse. Dizajni është frymëzuar nga format dinamike dhe ngjyrat e gjalla, duke sjellë një atmosferë festive dhe interaktive për fëmijët. Dimensionet do të jenë sipas modelit referuar në imazh.



4. Strukturë gjysëm harku me tullumbaca Kuq e Zi me përmasa 4.5 x 3 m.



5. **Tullumbace me helium**, material latex, jotoksik, rezistent ndaj shpërthimit. Forma rrethore, madhësia 30 cm me qëndrueshmëri 5-8 orë në ajër.

6. **Shërbim animatorë** (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme). Numri I animatorëve jo më pak se 4 persona, të ofrojnë lojra interaktive, kërcim, këngë Koha e shërbimit 3 orë.

Face Painting: Materiali duhet të jetë profesional, hipoalergjik dhe I sigurt për lëkurën. Të hiqet lehtësisht me ujë dhe me sapun. Koha e shërbimit 3 orë në varësi të aktivitetit.

Kllounët të jenë me costume me ngjyra të gjalla dhe dizajn tërheqës dhe të ndërvreprojnë me fëmijët. Koha e shërbimit 3 orë.

Xhonglierët duhet të bëjnë manipulime të ndryshme me topa, shkopinj dhe unaza. Koha e shërbimit 3 orë.

Maskotat duhet të jenë personazhe të animuara, superheronj etj. Duhet të ndërvreprojnë me fëmijët, të bëjnë fotografi me ta dhe të marrin pjesë në lojra të ndryshme. Koha e shërbimit 3 orë.

7. Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv

Dekor festiv i përbërë nga flamuj trekëndorë tekstili prej pambuku me dimensione **28 cm x 37 cm**. Flamujt do të jenë të lidhur me një shirit 8 metra të gjatë, të përshtatshëm për vendosje në ambiente të hapura dhe të mbyllura.

8. Workshop-i me një piktor profesionist, ku pjesëmarrësit do të mësojnë teknika të ndryshme të pikturës dhe të eksplorojnë kreativitetin e tyre përmes një eksperience praktike.

Diplomë ose trajnim profesional në **Arte Figurative, Pikturë, Dizajn apo fusha të ngjashme**

Aftësi për të **shpjeguar teknikat e pikturës në mënyrë të kuptueshme dhe praktike**

Tematika: Përcaktohet sipas eventit (p.sh., peizazhe, portrete, abstrakte, teknika të veçanta)

Kohëzgjatja: 3 orë

AKTIVITET 4

1. Grupe kërcimi të përbërë nga 10-15 fëmijë me moshë 7-16 vjeç të cilët do të performojnë kërcime të ndryshme në varësi të tematikës së aktiviteteve.

Kohëzgjatja: 1.5 orë

2. Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme). Numri I animatorëve jo më pak se 4 persona, të ofrojnë lojra interactive, kërcim, këngë. Koha e shërbimit 3 orë.

Face Painting: Materiali duhet të jetë profesional, hipoalergjik dhe I sigurt për lëkurën. Të hiqet lehtësisht me ujë dhe me sapun Koha e shërbimit 3 orë në varësi të aktivitetit.

Kllounët të jenë me kostume me ngjyra të gjalla dhe dizajn tërheqës dhe të ndërvrejnë me fëmijët. Koha e shërbimit 3 orë.

Xhonglierët duhet të bëjnë manipulime të ndryshme me topa, shkopinj dhe unaza. Koha e shërbimit 3 orë.

Maskotat duhet të jenë personazhe të animuara, superheronj etj. Duhet të ndërvrejnë me fëmijët, të bëjnë fotografi me ta dhe të marrin pjesë në lojra të ndryshme. Koha e shërbimit 3 orë.

3. Këngëtar profesionist për performancë live

KËRKESAT PËR KËNGËTARIN

Repertor i gjerë me këngë të ndryshme.

Zë i fuqishëm dhe i pastër, i përshtatshëm për performanca live.

Prezencë skenike dhe karizëm për të angazhuar publikun.

Ndërveprim me audiencën, për të mbajtur atmosferën e gjallë.

Fleksibilitet për të përshtatur performancën sipas kërkesave të organizatorëve.

Lloji i muzikës:

Këngë origjinale të këngëtarit.

Hite kombëtare dhe ndërkombëtare.

Muzikë e personalizuar sipas natyrës së eventit.

Kohëzgjatja: 1 orë

4. DJ profesionist për të performuar në evente publike

Repertor i gjerë me **muzikë të personalizuar sipas eventit.**

Eksperienca në **ndërveprim me publikun dhe krijimin e atmosferës.**

Aftësi teknike në përdorimin e pajisjeve DJ (CDJ, miksera, kontrolle digitale, etj.).

Fleksibilitet për të përshtatur performancën sipas llojit të eventit dhe dëshirave të organizatorëve.

Energjik, karizmatik dhe me aftësi për të mbajtur publikun aktiv gjatë gjithë performancës.

Kohëzgjatja: 4 orë

5. **Band muzikor rinor** për performancë live.

Përbërja e Bandit

- Minimum **3–5 anëtarë**, duke përfshirë instrumentistë dhe vokalist
- Aftësi për të performuar **cover-a të njohur dhe këngë origjinale**
- Energjik dhe me prezencë skenike për të mbajtur publikun të angazhuar
- Ndërveprim me audiencën për të krijuar atmosferë festive
- **Kohëzgjatja:** 2 orë

Shënim:Në të gjitha rastet kur është përmendur emri ose markë, njihet barazvleshmëria ose ekuivalent.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

AKTIVITETI 1

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Shërbim animator (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1
2	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me përmasa 28x37 cm të printuar	m/linear	200
3	Copë beze e printuar me imazh për ngjyrosje me bojra akrelik me diametër 2m	m/linear	50
4	Grup kërcimi me fëmijë dhe të rinj (1 orë)	shërbim	1
5	Workshop poçerie për 20 persona	shërbim	1
6	Moderator (4 orë)	shërbim	1
7	Këngëtar të zhanrit popullor	shërbim	2
8	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit (4 orë)	shërbim	1
9	Grup Sportiv Taekwondo	shërbim	1
10	Grup Sportiv Judo	shërbim	1
11	Instruktor Yoga	shërbim	1
12	Ekspozitë atelie me kostume dhe punime popullore	shërbim	1
13	Grup muzikor me muzikë alternative	shërbim	1

AKTIVITETI 2

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Ekspozitor metalik i personalizuar me imazhe të ndryshme me përmasa 1m x 1.5m	copë	10
2	Pikturë më bojra neoni në kanavacë dhe trup për 10 persona	shërbim	1
3	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit (3 orë)	shërbim	1
4	Instruktor Yoga	shërbim	2
5	Instruktor Pilates	shërbim	1
6	Sporte ujore KAYAK	shërbim	2
7	Workshop poçerie (20 persona)	shërbim	2
8	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1
9	Workshop me kostume dhe punime artizanale tradicionale 20 persona	shërbim	1
10	Tenda Dielli	copë	10
11	Show me rërë (sand art)	shërbim	1
12	Grup Jazz 2 orë	shërbim	1
13	Këngëtar lirik 2 orë	shërbim	2
14	Regjisor	shërbim	1
15	Moderator 3 orë	shërbim	1

AKTIVITET 3

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)200x100 cm	copë	1
2	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)174x80 cm	copë	1
3	Strukturë gjysëm harku me tullumbaca kuq e zi me përmasa 4.5 m x 3 m	copë	1
4	Tollumbace me helium	copë	300
5	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1
6	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me përmasa 28x37 cm te printuar	m/linear	200
7	Workshop me piktor 3 orë	shërbim	1

AKTIVITET 4

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Grup kërcimi	shërbim	2
2	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	1
3	Kengëtar	shërbim	2
4	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 4 orë	shërbim	1
5	Band muzikor rinor	shërbim	1

Tabele Permbljedhese e Aktiviteteve

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Band muzikor rinor	shërbim	1
2	Copë beze me diameter 2m e printuar	m/linear	50
3	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 3 orë	shërbim	1
4	DJ me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit 4 orë	shërbim	2
5	Ekspozitë atelie me kostume dhe punime popullore	shërbim	1
6	Ekspozitor metalik i personalizuar me imazhe të ndryshme me përmasa 1mx1.5m	copë	10
7	Flamur Trekëndor me Dizajn Festiv me përmasa 28x37 cm te printuar	m/linear	400
8	Grup Jazz 2 orë	shërbim	1
9	Grup kërcimi me fëmijë dhe të rinj (1 orë)	shërbim	1
10	Grup muzikor me muzikë alternative	shërbim	1
11	Grup Sortiv Judo	shërbim	1
12	Grup Sportiv Taekwondo	shërbim	1
13	Grup kërcimi	shërbim	2
14	Instruktor Yoga	shërbim	3
15	Këngëtar	shërbim	2
16	Këngëtar të zhanrit popullor	shërbim	2
17	Këngëtar lirik 2 orë	shërbim	2

18	Moderator 4 orë	shërbim	1
19	Moderator 3 orë	shërbim	1
20	Pikturë më bojra neoni në kanavacë dhe trup për 10 persona	shërbim	1
21	Regjisor	shërbim	1
22	Instruktor Pilates	shërbim	1
23	Shërbim animatorë (Facepainting, Klloun, Xhongelier, Maskota të ndryshme)	shërbim	4
24	Show me rërë (sand art)	shërbim	1
25	Sporte ujore KAYAK për 10 persona	shërbim	2
26	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)174x80 cm	copë	1
27	Strukturë dekorative me pjesë rrotulluese plastike (Spinwheels)200x100 cm	copë	1
28	Strukturë gjysëm harku me tullumbaca kuq e zi me përmasa 4.5 m x 3 m	copë	1
29	Tenda Dielli	copë	10
30	Tollombace me helium	copë	300
31	Workshop me kostume dhe punime artizanale tradicionale 20 persona	shërbim	1
32	Workshop me piktor 3 orë	shërbim	1

33	Workshop pocerie 3 orë 20 persona	shërbim	3

Afati i lëvrim: Deri me 31.12.2025

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ***Shpenzime për aktivitete të rëndësisë së veçantë***

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
